



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E DREJTËSISË - MINISTARSTVO PRAVDE - MINISTRY OF JUSTICE
DEPARTAMENTI PER PROFESIONE TE LIRA

Komisioni Disiplinor / Disiplinska Komisija / The Disiplinary Comitee

Nr. 05/2017

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Bajram Miftari-kryesues, Mahir Tutuli-anëtar dhe Fadil Hoxha-anëtar, në çështjen juridike disiplinore të përmbaruesit privat [REDACTED] i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, i dyshuar për shkelje disiplinore nga neni 367, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, pas përfundimit të seancës dëgjimore të datës 22.05.2017, ku ishin të pranishëm përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës - Departamenti për Profesione të Lira, Labinot Gashi, në cilësinë e propozuesit për fillimin e procedurës disiplinore dhe personalisht përmbaruesi privat, në cilësinë e të dyshuarit për shkelje disiplinore, në seancën për këshillim dhe votim, të datës 22.05.2017, mori këtë:

V e n d i m

I. [REDACTED], përmbarues privat i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, **ËSHTË PËRGJEGJËS** për shkelje disiplinore nga neni 367, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, të përshkruar si në propozimin për fillimin e procedurës disiplinore, të paraqitur nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës - Departamenti për Profesione të Lira, të datës 29.03.2017.

II. Për shkeljen disiplinore të lartcekur përmbaruesit privat, [REDACTED] shqiptohet masa disiplinore **gjobë në të holla**, në shumën prej 500.00 €, të cilën përmbaruesi privat është i detyruar ta paguaj në llogarinë bankare të mjeteve bugetore të Republikës së Kosovës, brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij vendimi.

A r s y e t i m i

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (në vazhdim të tekstit: Ministria), me datën 29.03.2017, ka paraqitur propozim për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat [REDACTED], i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, për shkak të dyshimit të bazuar se në lëndën përmbarimore të udhëhequr pranë zyrës së tij, P.nr.45/16, ka bërë shkelje disiplinore nga neni 367, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Propozimi është paraqitur në bazë të dhënave dhe informatave nga komisioni i Ministrisë së Drejtësisë, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së përmbaruesit privat.

Në propozim, ndër të tjera është theksuar se [REDAKTUAR] në lëndën përbarimore P.nr. 45/16, ka caktuar dhe ka zbatuar përbarimin duke u bazuar vetëm në aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, CN.nr.38/13 të datës 01.09.2014, pa e marrë parasysh aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.3837/2014, të datës 02.08.2016, si pjesë përbërëse e tij, gjë që ka rezultuar me përbarimin e një shume më të madhe financiare se sa shuma e gjykuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë. Po ashtu, përbaruesi privat ka bërë shkelje disiplinore edhe në lëndën P.nr.35/2016, nga se e ka ekzekutuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2380/07, të datës 14.01.2013, pa e marrë për bazë aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1526/13, ku kamata është dashur të llogaritet nga data 14.01.2013, e jo nga data 30.10.2007, gjë që ka rezultuar me tejkalim të shumës së përgjithshme të përbaruar. Me këtë propozim, i është propozuar Komisionit Disiplinor, që përbaruesit privat t'i shqiptohet masa disiplinore adekuate për veprat disiplinore me të cilat është ngarkuar.

Komisioni Disiplinor (në vazhdim të tekstit: Komisioni), me parashtresë me shkrim, e ka njoftuar përbaruesin privat për fillimin e procedurës disiplinore. Pastaj, me datën 04.05.2017, përbaruesi privat ka paraqitur para Komisionit deklaratën e tij me shkrim, ku ka parashtruar opinionin e tij rreth rastit.

Me datën 22.12.2016, Komisioni ka mbajtur seancën dëgjimore ku kanë qenë të pranishme të dy palët në procedurë. Përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë ka theksuar se mbetet pranë deklarimeve si në propozimin për fillimin e procedurës disiplinore. Ndërsa, përbaruesi privat, gjatë seancës ka deklaruar se i pranon gabimet e kryera, e pranon përgjegjësinë disiplinore dhe i ka premtuar Komisionit Disiplinor dhe Ministrisë së Drejtësisë, se do të kontaktoj palët në procedurë për të dy rastet përbarimore dhe do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme deri në kthimin e mjeteve të ekzekutuara që kanë tejkaluar titujt përbarimor.

Në seancën për këshillim dhe votim, Komisioni ka vendosur që rastin ta vendosë në bazë të pranimit të përgjegjësisë disiplinore, andaj, përbaruesin e ka shpallur përgjegjës për dy veprat disiplinore me të cilat është ngarkuar, pa pasur nevojë të bëhet administrimi i provave të lëndës. Në individualizimin e masës disiplinore, Komisioni ka marrë për bazë faktin se përbaruesi privat e ka pranuar përgjegjësinë disiplinore si dhe faktin se është zotuar se do të bëjë korigjimin e gabimeve, duke i kthyer mjetet e inkasuara së tepërmi, në llogarinë e dy debitorëve të dëmtuar. Nga ana tjetër, Komisioni Disiplinor nuk e ka pasur të njohur ndonjë rrethanë rënduese lidhur me përbaruesin privat, e cila do të duhej të merrej për bazë në individualizimin e masës disiplinore. Andaj, duke marrë për bazë natyrën e shkeljeve disiplinore, peshën e tyre, pasojat e tyre dhe rrethanat lehtësuese të larpërmendura, Komisioni vendosi që përbaruesit privat t'i shqiptojë masën disiplinore, gjobë në të holla, në shumën prej 500.00 €, e paraparë me nenin 368, paragrafi 1, pika 1.3 të Ligjit për Procedurën Përbarimore. Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartëcekura dhe në dispozitat e cituara më sipër, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR
Nr. 05/2017, me datën 22.05.2017

Kryesuesi i Komisionit Disiplinor,
Bajram Miftari



UDHËZIMI JURIDIK: Vendimi i Komisionit Disiplinor për Përbaruesit Privat është përfundimtar Kundër tij mund të ngritet konflikti administrativ (Neni 374.5 i LPP-së).